



KB4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR ERZEN

Nr.18/7 prot
dt. 08.01.2025

VENDIM

Nr.14, datë 23/12/2024

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI
UJOR NËNTOKËSOR (PUS-SHPIMI) PËR QËLLIME INDUSTRIALE,
TË SUBJEKTIT “DIEL” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje të subjektit “DIEL” sh.p.k, “Kërkesë për leje për përdorim të burimit ujor nëntokësor për qëllime industriale” (në impjantin e prodhimit të betonit), me vendndodhje, Njësia Administrative Rrashbull, Bashkia Durrës.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

-X= 455329.5; Y= 4580321.7; Z= 0.4 m

Prurja e ujit të kërkuar: $Q= 1$ l/sek

Prurja mesatare e ujit: $Q= 4$ l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 107 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 87 m

Koordinatat e pikës së shkarkimit në gropës septike (KRGJSH)

-X= 455324.8; Y= 4580324.4; Z= 0.2 m

3. Burimi ujq të përdoret vetëm për qëllimin e kërkuar (për qëllime industriale në fabrikën e betonit), dhe të mos përdoret për larje të inerteve lumore nëse subjekti nuk ka një leje aktive të shfrytëzimit të këtyre të fundit.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU ERZEN

AFRIM QËNDRO

